



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

VENDIM

Nr 107. Datë 14.10.2022

**MBI SHTYRJEN E PËRFUNDIMIT TË STUDIMEVE VETËM PËR STUDENTËT  
PËRSËRITËS TË VITIT III BACHELOR DHE VITIT II MASTER BRENDA VITIT  
AKADEMIK**

**2022-2023**

Bazuar në nenin 97, pika 2, të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; në nenin 128 të Statutit të UT-së; në Rregulloren e UT-së, duke marrë parasysh faktin që një numër i madh studentësh (lista bashkangjitur) si edhe faktin që kjo periudhë u shënjua nga dy fatkeqësi natyrore gjatë kohëzgjatjes normale të ciklit të tyre të plotë të studimeve, Dekanati në mbledhjen e tij të datës 13.10.2022,

**VENDOSI :**

1. Shtyrjen e përfundimit të studimeve brenda vitit akademik 2022-2023 për:
  - studentët e ciklit Bachelor të cilët janë regjistruar në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja në vitin akademik 2016-2017.
  - studentët e ciklit Master të cilët janë regjistruar në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja në vitin akademik 2018-2019.
2. Ngarkohet Sekretaria Mësimore që të lajmërojë studentët me email dhe të merren masa për plotësimin e kërkesave brenda datës 31 tetor 2022.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**DEKAN**

**Prof. Dr. Esmeralda KROMIDHA**

